



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 642/1 Prot.

Durrës, më 27.3.2024

VENDIM

Nr 27, datë 27.3.2024

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË
STUDIMIT TË DOKTORATURËS NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”
DURRËS”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të Administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të shkresës nr. 627 prot., datë 26.03.2024 të Zv.Rektorit për Çështjet Mësimore, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin e programeve të studimit të doktoraturës në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës”
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv.Rektorët,
 - Dekanët e fakulteteve.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksëanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Nr. 627 prot.

Durrës, më 26/3 /2024

Lënda: Përcillet Draft-Rregullorja "Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës".

REKTORIT

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

E nderuar Znj. Rektore,

Bazuar në Urdhërin nr. 92, datë 1.03.2024 për "Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Rregullores "Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", gjeni bashkëlidhur Draft-Rregulloren e përgatitur nga grupi i punës.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Prof.As.Dr. Llambi Prendi

DRAFT RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

Miratuar me Vendimin nr. 27 të Senatit Akademik

elotë 27.03.2024

Durrës 2024

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është të vendosë standarde të përbashkëta për organizimin e veprimtarinë së programeve të doktoraturës brenda njësive bazë të Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo Rregullore është bazuar në:

1. Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë",
2. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar,
3. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" i ndryshuar,
4. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26.12.2018, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore", i ndryshuar,
5. Vendim nr. 824, datë 24.12.2021 për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë,
6. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.2.2018, "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor",
7. Udhëzimin e MASR nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar,
8. Udhëzimin e MASR nr. 16, datë 08.07.2019, "Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave",
9. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor",
10. Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 18.12.2019 "Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë",
11. Udhëzimin e MASR nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar,

12. Udhëzimin e MASR nr. 10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor",
13. Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL",
14. Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,
15. Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,
16. Kodin e Etikës së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,
17. Kodin e Etikës në Kërkimit Shkencor të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Neni 3

Objektivat e programit të studimeve të doktoratës

1. Programet e studimit të doktoratës, mbështeten në pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Programet e doktoraturës janë pjesë e ciklit të tretë të studimeve, dhe pas përfundimit të tyre, studentëve u leshohet diploma për gradën shkencore "Doktor".
3. Programi i doktoraturës ka si qëllim të promovojë studimin e thelluar në një fushë specifike ose nënfushë, duke u fokusuar në zhvillimin, zgjerimin, rinovimin dhe riaplikimin e dijes shkencore, në mënyrë që të kontribuojë me inovacione në sferën e mendimit shkencor.
4. Studimet e doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës (disertacionit), të nevojshme për marrjen e gradës shkencore "Doktor" dhe lidhen me projekte kërkimore të njësisive bazë.
5. Programet e studimeve të doktoratës janë të strukturuar rreth planeve individuale që lejojnë zhvillimin e aftësive të pavarura të kërkimit shkencor të kandidatëve në fushat ose nënfushat të cilat janë caktuar nga njësitë bazë. Këto njësi bazë përcaktojnë dhe bëjnë publike fushat kryesore të studimit sipas qëllimeve të tyre akademike, ose fusha të ndërlidhura si prioritete për avancimin e kërkimit shkencor.

Neni 4

Organet

1. Njësitë bazë brenda Fakultetit mbajnë përgjegjësinë për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës.
2. Nëse programi i studimit ofrohet nga më shumë se një njësi bazë, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit të doktoratës, si edhe kriteret, përcaktohen në bashkëpunim të njësisive bazë me njëra-tjetrën. Në rast të programeve që përfshijnë më shumë se një njësi bazë, njëra prej njësisive bazë caktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakortësi midis tyre.
3. Përgjegjësi i programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore është Zëvendësdekani për kërkimin shkencor ose Zëvendësdekani i ciklit të tretë të studimeve, i cili i drejton ato në bashkëpunim me koordinatorët e programeve të studimit të doktoratës të njësisive bazë përkatëse.
4. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" pranë Njesisë Kryesore është përgjegjës për monitorimin e gjithë procesit të realizimit të programit të doktoraturës.
5. Vlerësimi i disertacionit të kandidatit për gradën shkencore "Doktor" realizohet nga juria e posaçme, e ngritur për këtë qëllim.
6. Organet dhe autoritete të tjera drejtuese përgjegjëse për funksionimin e doktoratës, mund të përcaktohen në rregulloret e programeve të studimit të njësisive kryesore apo njësisive bazë

Neni 5

Organizimi i programeve të studimit të doktoratës

1. Çdo njësi bazë mund të formulojë propozimin për hapjen e programeve të studimit të doktoratës, nëse plotëson kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.
 - a. Ka personel akademik me titull "Profesor i Asociuar" ose "Profesor";
 - b. Ka numrin e nevojshëm të personelit akademik për të udhëhequr çdo student të doktoratës në veprimtaritë e kërkimit dhe të detyrave përkatëse didaktike;
 - c. Ka struktura të posaçme operative dhe kërkimore për veprimtaritë e parashikuara nga programi i studimit të doktoratës (laboratorë, biblioteka dhe infrastrukturën e nevojshme);
 - d. Njësia bazë nëpërmjet njesisë kryesore, i paraqet Senatit të UAMD-së propozimin për hapjen e programit të ri të studimit të doktoratës ose për riorganizimin e një programi ekzistues propozim i cili formullohet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
2. Propozimi duhet të përmbajë:
 - a. Fushën/nënfushën e kërkimit shkencor dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës;
 - b. Afatet kohore të realizimit të programit të studimit;

- c. Fondet financiare për realizimin e procesit të studimit, përfshirë edhe mundësinë e vetëfinancimit ose të granteve për projekte kërkimore;
 - d. Parashikimin për numrin maksimal të studentëve, që mund të regjistrohen çdo vit në programet e doktoratës, i cili përcaktohet në përputhje me kapacitetet e njësisë bazë;
 - e. Kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues, të cilat përcaktohen nga njësia bazë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit të parë dhe të dytë;
 - f. Personelin akademik, që do të realizojë udhëheqjen e doktorantëve, si edhe nëse në ekipet mësimore do të përfshihet personel akademik i ftuar, i cili duhet të jetë i miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse;
 - g. Të dhëna për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës, që drejtojnë administrativisht programin e doktoratës, kur ato janë ndërdisiplinore;
 - h. Të dhëna mbi përvojat e mëparshme të strukturave në formime pasuniversitare. Nëse kanë pasur.
3. Studimet e doktoratës organizohen në kuadër të një projekti kërkimor-shkencor e zhvillimor dhe realizohen në koordinim me veprimtari të kërkimit të grupeve kërkimore brenda njësisë bazë, njësisive kryesore dhe UAMD-së.
 4. Këto njësi aplikojnë për financim pranë AKKSHI-së ose pranë institucioneve të tjera financuese kombëtare dhe ndërkombëtare.
 5. Në rastet e kandidatit me statusin e personelit akademik të brendshëm, studimet e doktoratës mund të mbështeten në burimet e brendshme të UAMD-së.
 6. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, kandidati mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo dhe të vetëfinancohet.

Neni 6

Afatet në lidhje me pranimin në ciklin e tretë të studimeve

1. Çdo njësi bazë duhet të përcaktojë kuotat e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 30 e muajit nëntor. Kuotat i përcillen Senatit Akademik të UAMD-së për miratim.
2. Çdo njësi kryesore ka detyrimin të bëjë publike kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit, sipas një liste të qartë dhe transparente për pikëzimin e kriterëve specifike të përcaktuara nga njësitë bazë për të gjitha fushat e kërkimit shkencor që ofron. Këto kriteret nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.
3. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e studimit të doktoratës, publikohen në faqen zyrtare të internetit të çdo njësie kryesore dhe të IAL-

së, si dhe në ambientet e tyre, të paktën një muaj përpara mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave.

Neni 7

Kërkesat themelore dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve

1. Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:
 - a. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e kërkuar dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve"; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
 - b. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
 - c. Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të parë dhe të dytë sipas përcaktimeve të kodit të cilësisë në arsimin e lartë dhe përcaktimeve të njësisë bazë.
 - d. Të ketë angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo të jetë personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, studentët e ekselencës janë të përjashtuar nga kjo kërkesë.
 - e. Të ketë dy rekomandime nga personel akademik që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor" të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit.
 - f. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.
 - g. Njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës mund të përcaktojnë edhe kritere të tjera shtesë.
2. Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, e cila përfshihet në dosjen personale, që dorëzohet në njësinë bazë dhe përmban dokumentet e mëposhtme:
 - a. Curriculum Vitae;

- b. Kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listen e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin; kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë "Master ekzekutiv", diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listen e notave ose suplementin e diplomës, nese kandidati ka të tilla;
 - c. Certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
 - d. Dy rekomandime nga personel akademik me titull "Profesor i Asociuar" ose "Profesor";
 - e. Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas pikës 1 b;
 - f. Dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore;
 - g. Deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
 - h. Deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
 - i. Propozimi i kërkimit shkencor, ku të evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar si dhe risitë, që pritet të sjellë punimi, plani i punës kërkimore shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
 - j. Vërtetim nga qendra e punës, që vërteton se kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo është personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
 - k. Mandat pagese për tarifën e aplikimit;
 - l. Vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
 - m. Dokumenta të tjera që vërtetojnë plotësimin e kritereve të shpallura.
3. Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentacionin e mësipërm nuk merren në shqyrtim nga komisioni ad-hoc.
 4. Dosja e kërkesës për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës shqyrtohet nga një komision ad-hoc, i ngritur nga njësia bazë, që mbajnë titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar".
 5. Komisioni ngrihet me urdhër të drejtuesit të njësisë bazë dhe bën vlerësimin e dosjeve sipas kritereve të publikuara nga njësia kryesore.
 6. Komisioni ad-hoc, pas verifikimit të përmbushjes së kritereve themelore, bën përzgjedhjen e kandidatëve, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin e kritereve specifike të aplikantëve.

7. Lista e kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni ad-hoc, miratohet në mbledhjen e njësisë bazë brenda 15 ditëve nga ngritja e komisionit ad-hoc. Lista e miratuar shpallet në faqen zyrtare dhe ju njoftohet kandidateve në rrugë elektronike.
8. Njësia bazë njofton me shkresë përcjellëse Dekanin për kandidatët fitues.
9. Kandidati fitues regjistrohet në sekretarinë e doktoratës jo më vonë se 10 ditë pas marrjes së njoftimit për kualifikimin e kërkesës së tij.
10. Dosja e doktorantit ruhet pranë sekretarisë së doktoraturës. Kjo e fundit është përgjegjëse edhe për ruajtjen elektronike të dosjes.
11. Midis kandidatit fitues, udhëheqesit dhe përgjegjësit të programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore, lidhet një kontratë tip.

Neni 8

Procedura e ankimimit

1. Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda pesë ditëve të punës nga njoftimi në rrugë elektronike dhe shpalljes së e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimimi bëhet me shkrim pranë sekretarisë së doktoraturës së njësisë kryesore dhe i përcillet drejtuesit të njësisë bazë.
2. Në rast ankimimi Drejtuesi i Njesisë Bazë mbledh departamentin për shqyrtimin e ankimimit dhe del me një vendim duke e pranuar ose rrëzuar atë.
3. Vendimi i njësisë bazë merret me shumicën e votave të anëtarëve dhe është përfundimtar dhe i paankimueshëm.

Neni 9

Udhëheqësi Shkencor dhe kapacitetet për udhëheqje

1. Udhëheqësi shkencor për studentin aplikant në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar".
2. Kur fusha e studimit të doktorantit është ndërdisiplinore, doktoranti mund të kërkoj bashkëudhëheqës. Kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushë bashkëudhëheqësi përcaktohen në rregulloren e programeve të doktoraturës në nivel njësie kryesore apo njësie bazë.
3. Në rastet e programeve të përbashkëta të studimit me një institucion të vendeve të Bashkimit Evropian, SHBA-ve dhe Kanadasë, bashkëudhëheqësi në një instituicon pritës mund të jetë me gradën shkencore "Doktor".
4. Numri i doktorantëve që mund të udhëheqë personeli akademik në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, brenda vendit dhe udhëheqjet/bashkëudhëheqjet që ndjek në institucionet e arsimit të lartë brenda vendit ose vendet anëtare të OECD-së, BE-së ose G. 20-ës ku ai është angazhuar përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi

5. E drejta për drejtimin shkencor të një programi doktorate nuk mund të transferohet dhe as të tjetërsohet, përveçse në rastet kur:
 - a. Udhëheqësi shkencor humbet aftësinë për të kryer punën kërkimore shkencore për një periudhë që kalon një vit akademik ose përgjithmonë e vërtetuar kjo me një raport mjekësor.
 - b. Deklaron me shkrim dorëheqjen e parevokueshme nga drejtimi i projektit kërkimor shkencor.
 - c. Humb jetën.

Procedura e zëvendësimit apo transferimit të të drejtës së drejtimin shkencor përcakohet në rregulloret e programit të studimit në nivel Njësia Kryesore apo Njësia Bazë.

Neni 10

Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të studimit të doktoratës

1. Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, studenti i doktoraturës nën drejtimin e udhëheqësit duhet që të plotësojë kriteret e parashikuara në VKM që rregullon kriteret që duhet të plotësohen për marrjen e gradës shkencore Doktor.
2. Në rregulloret e programeve të studimit në nivelin e Njesisë Bazë apo Njesisë kryesore përcaktohen në mënyrë të detajuar kërkesat, që duhet të plotësojnë studentët për marrjen e grades shkencore "Doktor".
3. Të paktën një herë në vit, njësia bazë duhet të shqyrtojë ecurinë e punës së studentit në programin e studimeve të doktoratës, bazuar në prezantimet vjetore të punës, që ai/ajo bën dhe vlerësimeve me shkrim që bën udhëheqësi, sipas një formati të paracaktuar në përputhje me kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe për vazhdimin e punës për projektin kërkimor të miratuara nga Senati Akademik.
4. Të përfundojë disertacionin në përputhje me kriteret dhe brenda afateve të parashikuara në këtë rregullore. Disertacioni së bashku me dosjen, që përmban dokumentacionin që tregon plotësimin e kriterëve si më sipër, pasi miratohet nga udhëheqësi shkencor i dorëzohet drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, për të vijuar më tej me procedurat për mbrojtje, sipas përcaktimeve në vijim në këtë rregullore.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrat e studentit të doktoratës

1. Studentit i njihet e drejta:
 - a. Të pajiset me paketën e akteve ligjore dhe nënligjore, që janë në funksion të procesit të studimeve të doktoratës dhe mbrojtjes së disertacionit për fitimin e gradës shkencore "Doktor";

- b. Të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive akademike dhe shkencore të parashikuara në programin e tij të studimeve të doktoratës;
 - c. Të shfrytëzojë bibliotekën e njësisë kryesore apo të njërive të tjera të UAMD-së, në varësi të specifikave përkatëse të kërkimit;
 - d. Të shfrytëzojë bibliotekat e njërive të institucioneve me të cilat UAMD ose njësi kryesore ka marrëveshje bashkëpunimi në fushën akademike apo/dhe shkencore, duke paraqitur pranë këtyre institucioneve dokumentin e lëshuar nga njësi kryesore, mbi qëllimin e studimit të kërkimit dhe statusin e tij si student i ciklit të tretë;
 - e. Të shfrytëzojë ambientet studimore/kërkimore dhe bazën e të dhënave pranë institucioneve publike/private, që do të mund ti nevojiten atij për kërkimin shkencor, mbi bazën e rekomandimeve që njësi kryesore do të lëshojë rast pas rasti;
 - f. Të tërhiqet vullnetarisht nga studimet e doktoratës, duke paraqitur kërkesën me shkrim pranë njësisë bazë;
 - g. Të përfitojë financim nga subjekte të tjera ose të vetëfinancojë studimet e doktoratës;
 - h. Studenti ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe/ose dosjen e plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj, në rast se njësi bazë jep vlerësim negativ për disertacionin.
2. Studenti ka për detyrë:
- a. Të njohë dhe të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, përfshirë dhe këtë rregullore;
 - b. Të respektojë programin e miratuar të kërkimit të doktoratës;
 - c. Të respektojë afatet e parashikuara për realizimin e studimeve të doktoratës dhe shlyerjen e detyrimeve financiare (për studentët që janë me vetëfinancim);
 - d. Të raportojë, të paktën një herë në vit, në njësinë bazë të programit mbi ecurinë e punës për realizimin e programit të kërkimit dhe veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore;
 - e. Të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për doktoratën në këtë rregullore dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore;
 - f. Të respektojë etikën dhe integritetin në kërkimin shkencor gjatë hartimit të disertacionit;
 - g. Të dorëzojë brenda afateve ligjore disertacionin dhe dosjen përkatëse, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 12

Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor

1. Nëse vlerësohet prej udhëheqësit, ai harton programin e detajuar për kualifikimin e thelluar teorik të detyrueshëm për studentin që ka pranuar të udhëheqë.

2. Formulon hipotezat kryesore të kërkimit shkencor që do t'i ngarkohen studentit për t'i verifikuar.
3. Miraton planin vjetor të punës të detajuar në tremujor, i cili hartohet nga doktoranti.
4. Në fund të çdo viti akademik shqyrton dhe miraton raportin e aktiviteteve të kryera nga doktoranti, dhe e depoziton në dosjen e doktorantit.
5. Të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike të kërkimit shkencor, gjatë periudhës së udhëheqjes së doktoratës.
6. Të udhëheqë studentin për realizimin e kërkimit shkencor dhe përfundimin e disertacionit brenda kohës së parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore.
7. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit arritjen e standardeve të larta të kërkimit shkencor. Kjo përfshin, ndër të tjera, edhe orientim në lidhje me strukturën e punimit, metodologjinë, rekomandime mbi literaturën dhe burime të tjera të informacionit, si edhe konsulencë të vazhdueshme për përmbajtjen e punimit.
8. Të mbajë komunikime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit shkencor.
9. Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht dhe të monitorojë punën e tij në përputhje me standardin e kërkuar. Të ndërgjegjësojë studentin, në rastet kur puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
10. Të mbështesë studentin për përgatitjen e materialeve kërkimore, përfshirë artikuj dhe prezantime për konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në botime të tjera shkencore, kur tematika e tyre është në funksion të kërkimit shkencor dhe punimit të doktoratës dhe në përmbushje të kriterëve të përcaktuara.
11. Të kontrollojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejet dhe rekomandimet, në rastet kur njësia bazë e ka kthyer punimin për riparaqitje dhe/ose plotësimin e dosjes.
12. Në rastet e bashkëudhëheqjes, udhëheqësit duhet të përcaktojnë qartë përgjegjësitë e tyre dhe duhet të mbajnë kontakte të rregullta.
13. Udhëheqësi shkencor ka përgjegjësi të ndërgjegjësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe plagjiaturës.
14. Shqyrton rezultatet e arritura në përfundim të projektit kërkimor-shkencor dhe jep miratimin për fillimin e procedurave për mbrojtjen përfundimtare.

Neni 13

Përgjegjësitë e njësisë bazë

1. Njësia bazë është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.

2. Njësia bazë përcakton dhe miraton fushat/nënfushat e kërkimit shkencor, ku do të zhvillohen projektet e doktoratës. Kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura midis dy ose më shumë njësive bazë, njëra prej njësive bazë përcaktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakortësi midis tyre.
3. Njësia bazë përcakton kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe për vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor dhe ia paraqet për miratim Senatit Akademik.
4. Njësia bazë bën vlerësimin e disertacionit dhe të dosjes kandidatit më pas e përcjellë atë për vlerësim pranë Komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor".
5. Njësia bazë përcakton kuotat dhe kriteret për pranimin e studentëve doktorantë, shqyrton dhe miraton listën e kandidatëve fitues në programin e tij të doktoratës.
6. Njësia bazë miraton projektet kërkimore.
7. Njësia bazë ka përgjegjësi t'ju sigurojë studentëve doktorantë lehtësitë e nevojshme administrative për marrjen e informacionit dhe të literaturës së nevojshme kërkimore-shkencore pranë institucioneve publike dhe private.
8. Njësia bazë ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kriterëve formale dhe ato të antiplagiaturës nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".
9. Njësia bazë ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme propozon ndryshimet e nevojshme.
10. Njësia bazë ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse përfshirë edhe këtu edhe rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.
11. Në kushtet e kërkesës për ndryshimin e temës së disertacionit, doktoranti paraqet një raport drejtuar drejtuesit të njësisë bazë, të nënshkruar prej tij dhe udhëheqësit ku të argumentohet ndryshimi i temës. Tema duhet të jetë brenda fushës së kërkimit dhe pjesë e projektit kërkimor shkencor të udhëheqësit shkencor. Drejtuesi i njësisë bazë, vendos për miratimin ose jo të ndryshimit të temës së disertacionit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i kërkesës.
12. Përveç detyrave të parashikuara si më lart, njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës mund të përcaktojnë dhe detyra të tjera shtesë.

Neni 14

Detyrat e përgjegjësit të programeve të studimeve të doktoratës

1. Programet e doktoratës në nivel të njësisë kryesore ndiqen/drejtohen nga përgjegjësi i programeve të studimit të doktoratës, që është Zëvendësdekani për kërkimin shkencor ose Zëvendësdekani i ciklit të tretë të studimeve, i cili ka përgjegjësi:
 - a. Të mbikqyrë dhe të sigurojë që njësitë bazë respektojnë, në ushtrimin e përgjegjësi të tyre në lidhje me programet e studimit të doktoratës, kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, këtë rregullore, në drejtim të:
 - i. Respektimit të afateve dhe të kriterëve për shpalljen e hapjes së programit të doktoratës;
 - ii. Respektimit të rregullave në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve fitues;
 - iii. Respektimit të kriterëve në lidhje me udhëheqësit shkencorë, përfshirë, por jo vetëm, kriteret në lidhje me titullin akademik, që duhet të ketë udhëheqësi (“Profesor” ose “Profesor i asociuar”), numrin maksimal të doktorantëve që mund të udhëheqë, ekspertizën në fushën specifike të kërkimit si edhe mundësitë reale në ofrimin e një udhëheqëje cilësore për kandidatët;
 - b. Respektimit të procedurave të udhëheqjes dhe shqyrtimit të ecurisë së kërkimit shkencor.
 - c. Të mbikqyrë dhe të sigurojë që studentët e doktoratës të informohen për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime dhe rregullore, që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore "Doktor".
 - d. Të garantojë se udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës së kërkimit, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij.
 - e. Të shqyrtojë raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t ka/në kontakt, të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, i propozon njësisë bazë ndryshimet e nevojshme.
 - f. Të garantojë se procedura e mbikqyrjes dhe e shqyrtimit të ecurisë së kërkimit është e rregullt.
2. Përveç detyrave të parashikuara si më lart, njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës mund të përcaktojnë edhe detyra të tjera shtesë, që garantojnë funksionimin e këtij programi studimi.

Neni 15

Detyrat e koordinorit të programit të studimit të doktoratës

1. Programi i studimit të doktoratës në nivel të njësisë bazë ndiqet/drejtohet nga koordinatori i programit të studimit të doktoratës, që zgjidhet ndërmjet anëtarëve të

Njesisë Bazë që kanë titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i asociuar", i cili ka përgjegjësi:

- a. Të kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqësin shkencor, sipas rregullave për caktimin e udhëheqësit shkencor të studimeve të doktoratës;
 - b. Ndjek të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe zbatimin e programit të kërkimeve dhe angazhimit të personelit akademik të kualifikuar në fushën shkencore të këtij program;
 - c. Shërben si hallkë ndërlidhëse ndërmjet doktorantëve, Drejtuesit të Njesisë Bazë dhe Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" pranë Njesisë Kryesore;
 - d. Të garantojë se udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës/nënfushës së kërkimit shkencor, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij;
 - e. Të garantojë se kandidatët i plotësojnë standardet për të punuar temën;
 - f. Të interesohet për t'i siguruar kandidatëve lehtësirat e nevojshme;
 - g. Të garantojë se për zhvillimin e doktoratës zbatohen standardet e kërkimeve shkencore;
 - h. T'u bëjë studentëve të njohur të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj., që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore.
2. Përveç detyrave të parashikuara si më lart, njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës mund të përcaktojnë dhe detyra të tjera shtesë, që garantojnë funksionimin e këtij programi studimi.

Neni 16

Përgjegjësitë e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor"

1. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" është Komision i Përhershëm që ngrihet në nivel njësie kryesore. Ngritja e këtij komisioni miratohet nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Ai është përgjegjës për monitorimin e procesit të dhënies së gradës shkencore "Doktor".
3. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dosjes së kandidatit dhe nëse vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktuara në këtë rregullore ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në shqyrtim e dosjes nga njësia bazë.
4. Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me dhënien e gradës Shkencore "Doktor", pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të jurisë.
5. Komisioni shqyrton dhe jep rekomandime në lidhje me mosmarrëveshjet midis doktorantëve dhe udhëheqësit shkencor.

6. Përveç detyrave të parashikuara si më lart, njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës mund të përcaktojnë dhe detyra të tjera shtesë.

Neni 17

Personeli ndihmës akademik me karakter administrative për ciklin e tretë të studimeve

1. Për organizimin e procesit të punës dhe për mbarëvajtjen në ushtrimin e funksioneve nga organet përgjegjëse të programit të doktoratës caktohet sekretaria e doktoraturës e cila është pjesë përbërëse e sekretarisë mësimore të Fakultetit.
2. Ajo përbëhet nga një ose më shumë personel ndihmës akademik me karakter administrative me kohë të plotë e cila caktohet nga ana e Drejtuesit të Njesisë Kryesore.
3. Sekretaria e Doktoraturës kryen funksionet e mëposhtme:
 - a) Mban protokollin e programit të doktoraturës sipas ligjit për protokollin dhe arkivat;
 - b) Mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e aplikantëve dhe doktorantëve;
 - c) Pranon dhe administron kërkesat për konkurim për të drjetë studimi në ciklin e tretë të studimeve;
 - d) Regjistron kandidatët konkurentë sipas çdo njësie bazë;
 - e) Përgatit dosjet e kandidatëve në aplikim për shqyrtim dhe ua dorëzon ato komisioneve ad-hoc të ngritura pranë departamenteve;
 - f) Asiston në cilësinë e mbajtësit të protokollit të mbledhjeve të Njesisë bazë dhe të Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor” sipas udhëzimeve të Drejtuesit të Njesisë Bazë dhe të Kryetarit të Komisionit për dhënien e grades shkencore “Doktor”;
 - g) Bën njoftime për rendin e ditës dhe orën e mbledhjes së Komisionit jo më vonë se një javë përpara mbledhjes dhe merr masa për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit si dhe bën njoftime për ndryshime në rendin e ditës 24 orë përpara mbledhjes;
 - h) Mban procesverbalin e mbledhjeve të Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
 - i) Përgatit dhe shumfishon dokumentacionin, procesverbalet, shkresat dhe materialet e tjera mësimore për zhvillimin e programit të doktoraturës;
 - j) Afishon dhe njofton në mënyrë elektronike rezultatet e konkurimit për studimet e doktoratës;
 - k) Harton dhe mban regjistrin e studentëve që kryejnë studimet në ciklin e tretë “Doktoratë”;
 - l) Merr në dorëzim dhe shpërndan korrespondencën dhe materiale të tjera që lidhen me doktoraturën;
 - m) Pret kërkesat dhe ankimet nga kandidatë dhe/ose student të Doktoratës dhe i dërgon ato për shqyrtim tek organi përgjegjës;

- n) Arkivon në mënyrë shkresore dhe elektronike dokumentacionin në lidhje me programin e Doktoratës që zhvillohet në njësinë bazë;
- o) Lajmëron dhe afishon informacione për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarive të ndryshme të programit të doktoratës;
- p) Merr masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit të doktoratës nga rreziqet e ndryshme si zjarri, uji, dëmtimet shpërdorimet etj.

Neni 18

Afati i studimeve të doktoratës

1. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një instituicion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
2. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se 3 (tri) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike.
3. Në raste përjashtimore, me kërkesë të studentit. Komisioni i Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" mund të vendosë vetëm një herë për shtyrjen ose për pezullimin e studimeve të doktoratës, por jo më shumë se 2 (dy) vite në total.

Neni 19

Organizimi i procesit të miratimit të programeve të përbashkëta ose ndërdisiplinore të doktoratës

1. Programet e përbashkëta ose ndërdisiplinore të studimit realizohen nga Universiteti ose Fakulteti, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit në përputhje me marrëveshje bashkëpunimi të lidhura duke përcaktuar dhe njësinë përgjegjëse.
2. Në programet ndërdisiplinore të doktoratës, njësitë bazë duhet të kenë në konsideratë që:
 - a. Fushat/nënfushat e kërkimit të jenë të ndërthurura dhe të përafërta;
 - b. Programi i studimit të doktoratës dhe përgatitja e tezës së disertacionit të kryhen me periudha të alternuara, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit;
 - c. Të caktohen dy udhëheqës, një për secilën njësi, të përfshirë në këtë program. Vlerësimi pozitiv i secilës njësi bazë është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së doktoratës;
 - d. Procedura për mbrojtjen e gradës shkencore "Doktor" realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - e. Në përfundim të studimeve, njësia kryesore dhe IAL-të homologe apo njësitë bazë lëshojnë diplomë të përbashkët apo të dyfishtë/shumëfishtë, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.
4. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin e ministries përgjegjëse për arsimin.

Neni 20

Formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës

1. Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) anëtarë i përkasin personelit akademik të njërive bazë nga institucionet homologe vendase ose të huaja.
2. Ngritja e jurisë bëhet pasi kandidati i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në këtë rregullore si dhe ka përfunduar disertacionin e tij. Ai e dorëzon disertacionin e përfunduar, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njësia bazë të plotësimit të kriterëve formale dhe kontrollit antiplagjiaturë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.
3. Komisioni përzgjedh anëtarët e Jurisë nga një listë me jo më pak se 8 (tetë) anëtarë, propozuar nga njësia bazë dhe e miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore. Anëtarët e jurisë duhet ti përkasin kategorisë "Profesor". Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit ku njëri është anëtar i jashtëm. Njëri prej anëtarëve të jurisë caktohet kryetar i saj.
4. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.
5. Kur, për arsye të përligjura, njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, përgjegjësi i njësisë bazë vë në dijeni drejtuesin e njësisë kryesore, duke i propozuar edhe një datë tjetër për mbrojtjen. Drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Juria merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës pas njoftimit dhe miratimit paraprak nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Kjo procedurë zbatohet edhe në rastin kur doktoranti, për arsye të përligjura, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës.
6. Pas prezantimit të disertacionit nga doktoranti, juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon atë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".

7. Komisioni, pasi merr Raportin e Vlerësimit nga juria, brenda 10 (dhjetë) ditëve merr vendimin mbi dhënien e gradës shkencore "Doktor" dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.
8. Njësitë bazë në rregulloret e tyre të programit të studimit të doktoratës përcaktojnë në mënyrë më të detajuar procedurat e nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e Jurisë.

Neni 21

Mbrojtja e doktoratës

1. Mbrojtja e doktoratës bëhet, si rregull, e hapur me përjashtim të rasteve kur, për natyrën e veçantë të çështjeve të trajtuara (sekrete, të dhëna konfidenciale etj.) duhet të bëhet e mbyllur. Drejtuesi i njësisë kryesore, me kërkesë të njësisë bazë, autorizon mbrojtjen me publik të kufizuar, sipas propozimit të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".
2. Komisioni i integritetit akademik, duke përdorur software që kontrollojnë në mënyre automatike për plagjiaturë certifikon disertacionin përpara mbrojtjes në juri.
3. Disertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë.
4. Në rregulloret e programeve të studimit të Njësive Bazë apo Njësive Kryesore parashikohen në mënyrë më të detajuar i procesit të mbrojtjes, duke përfshirë, prezantimin nga Kryetari i Jurisë, prezantimin nga ana e disertantit, paraqitja e oponencave, diskutimet, sqarimet nga ana e doktorantit dhe udhëheqësit, menyrën dhe procedurën e vlerësimit.
5. Juria e vlerësimit përgatit një raport të detajuar, për vlerësimin e studentit të doktoraturës dhe ja përcjell Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor", për marrjen e vendimit për dhënien e gradës.
6. Komisioni i Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" i njësisë kryesore në rregulloren e funksionimit të tij përcakton në mënyrë të detajuar procesin e vendimarrjes për dhënien e gradës shkencore "Doktor".
7. Pas mbrojtjes së doktoratës dhe marrjes së vendimit në Komisionin e Përhershëm, njësia përcjell një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në bibliotekën shkencore të universitetit dhe Fakultetit dhe një kopje në formatin elektronik në UAMD.
8. Pas përfundimit të procedurave të mbrojtjes së doktoratës dosja e plotë e studentit të Doktoratës arkivohet në arkivën e Fakultetit të së bashku me një kopje të tezës së doktoraturës.
9. Në përfundim të studimeve lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor", e cila nënshkruhet nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe Rektori.

10. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë i përcillet universitetit dhe prej andej Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të IAL-së.

Neni 22

Mospërfundimi ose ndërprerja e studimeve të doktoratës

1. Në rast se doktoranti nuk arrin të përfundojë ose ndërpret përgatitjen e disertacionit brenda afatit të caktuar, ai mund të pajiset me një vërtetim për rezultatet e arritura.
2. Vërtetimi lëshohet nga drejtuesi i njësisë kryesore, pas konceptimit nga drejtuesi i njësisë bazë në lidhje me arritjet e studentit të doktoratës.
3. Drejtuesi i njësisë bazë vë në dijeni Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".

Neni 23

Anulimi i gradës shkencore "Doktor"

1. Nëse pas mbrojtjes së disertacionit ka të dhëna të besueshme, konstatohet dhe/ose vërtetohet se grada shkencore "Doktor" është fituar në shkelje të rregullave të etikës mbi kërkimin shkencor, ose kur mbrojtja është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor, fillon procedura për anulimin e kësaj grade. Rregulloret e njësisë kryesore përcaktojnë më tej procedurat, që do të ndiqen për anulimin e gradës shkencore "Doktor".
2. Personi për të cilin fillon procesi i shqyrtimit të gradës shkencore "Doktor", duhet të njoftohet në lidhje me fillimin e procedurës për anulimin e gradës shkencore "Doktor" me shkakun, procedurat që do të ndiqen dhe mbi të drejtën që ka për t'u mbrojtur në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 24

Rregullat për paraqitjen e disertacionit

1. Disertacioni hartohet në gjuhën Shqipe dhe një përmbledhje e tij hartohet në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht), në format të shtypur dhe elektronik. Përpara dorëzimit disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor.
2. Disertacioni lidhet në pesë kopje origjinale. Në kopertinë duhet të vendoset:
 - a. Emri i Universitetit (në krye, në mes të kopertinës);
 - b. Emri i Fakultetit (në krye, mes të kopertinës);
 - c. Emri i Departamentit, ku është zhvilluar programi i doktoratës (në krye, në mes të kopertinës);

- d. Stema e Universitetit (në krye, në anën e majtë të kopertinës);
 - e. Stema e Fakultetit (në krye, në anën e djathtë të kopertinës);
 - f. Fjala DISERTACION (në mes të kopertinës);
 - g. Emri i programit të doktoratës (në mes të kopertinës);
 - h. Emri i kandidatit (në fund, në anën e majtë të kopertinës);
 - i. Emri dhe grada e udhëheqësit (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);
 - j. Qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të kopertinës).
3. Njësitë bazë përcaktojnë në rregulloret e tyre specifikimet teknike për punimin, si: kriteret për formatin, gjatësinë e punimit, llojin e letrës, hapësira midis rreshtave, llojin e shkrimit, margjinat, emërtimi, shënimet, tabelat, diagramet, materialet shoqëruese, citimet dhe referencat dhe çdo element tjetër të lidhur me formatimin.

Neni 25

Etika e punës kërkimore

1. Cdo disertacion duhet të reflektojë rregullat që lidhen me etikën e punës kërkimore dhe integritetin akademik, në respektim të etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor të përcaktuar në Kodin e Etikës për Kërkimin Shkencor si dhe në Kodin e Etikës në UAMD
2. Kur dorëzon disertacionin, kandidati duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij.
3. Kandidati nuk lejohet të paraqesë të njëjtin punim që e ka paraqitur më parë në të njëjtën njësi ose në një njësi tjetër për marrjen e një grade tjetër. Punimi i doktoratës mund të përfshijë pjesë të studimeve të mëparshme, nëse ai tregon qartë në disertacion se cila pjesë e punës është përdorur më parë. Rregulloret e njësive bazë përcaktojnë masën që i lejohet të përfshihet nga punimet e mëparshme, në disertacionin e doktoratës.
4. Kandidati mund të përfshijë në disertacion edhe pjesë nga studime individuale apo të realizuara me bashkautorë, ose të dhëna të përfituara nga kërkime në kuadër të projekteve kërkimore të tjera. Nëse kërkimi është realizuar në ekip, kandidati e evidenton këtë fakt dhe njeh kontributin e bashkëpunëtorëve.
5. Gjatë periudhës së përgatitjes së disertacionit kandidati mund të botojë pjesë të studimit shkencor në formën e artikujve apo të referimeve shkencore.
6. Punimi nuk duhet të përmbajë elemente, që përbëjnë plagjiaturë. Në çdo rast që përdoren ide, fjalë apo koncepte nga burime të tjera duhet të shënohet referenca përkatëse.
7. Nëse burimi origjinal nuk gjendet, por ai është përmendur në një dokument tjetër, atëherë duhet të citohen të dy dokumentet burimi origjinal dhe burimi dytësor.
8. Udhëheqësi duhet të sqarojë kandidatin, që në fillim të punës, për rrezikun dhe pasojat në rastet e konstatimit të mashtrimit, falsifikimit dhe plagjiaturës.
9. Pronësia intelektuale e drejta e autorit për punimin (si edhe për çdo material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës të autorit dhe akte të tjera të zbatueshme në këtë drejtim.

Shënimi për rezervimin e së drejtës së autorit, simboli përkatës C, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen, që vjen pas titullit të punimit.

Neni 26 Financimi

1. Vlera e doktoratës planifikohet dhe mbulohet nga fondet për kërkim shkencor të njësisë bazë organizuese ose të njësisë kryesore dhe/ose nga grantet e punës kërkimore-shkencore, që financohen nga buxheti i shtetit në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi dhe/ose nga institucione të tjera financuese dhe/ose nga burime të tjera publike dhe jopublike.
2. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të vetëfinancohet:
 - a. Vetëfinancimi i studimeve të Doktoratës bëhet në bazë të një marrëveshje të firmosur nga ana e studentit të doktoratës, Udhëheqësit Shkencor, Drejtuesit të Njesisë Bazë;
 - b. Modeli i kontratës, elementët e saj si dhe kostoja e studimeve miratohen nga ana e Bordit të Administrimit;
 - c. Kontrata e vetëfinancimit miratohet nga ana e administratorit të UAMD.
3. Tarifat e studimeve të doktoraturës përcaktohet me Vendim të Bordit të Administrimit. Pagesa e saj bëhet çdo fillim viti akademik

Neni 27 Vula dhe logo dhe Ruajtja e dokumentacionit.

1. Programet e studimit të doktoraturës pranë Njësive Kryesore do të përdorin vulën zyrtare dhe logon e fakulteve që ofrojnë studimet e doktoraturës.
2. I gjithë dokumentacioni për ecurinë e doktorantit ruhet në tri kopje. Një kopje e këtij dokumentacioni ruhet në njësinë bazë përkatëse dhe një tjetër nga Koordinatori i programit të doktoraturës.

Neni 28 Dispozita kaluese

1. Në rregulloret e hartuara nga njësitë bazë apo njësitë kryesore për organizimin dhe funksionimin e programit të tyre të studimit të doktoratës duhet të harmonizohen me dispozitat e kësaj rregulloreje brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e saj dhe duhet të gjejnë rregullim edhe elementët e mëposhtëm:
 - a. kontrolli i plagjiaturës si edhe niveli i pranuar i saj;
 - b. skemat dhe mënyrat e financimit të programit të studimit doktoratës;

- c. kriteret specifike për afatet e pagesës për të gjithë ciklin e programit të studimit të doktoratës;
- d. kriteret specifike kur studimet e doktoratës ndërpriten, shtyhen ose pezullohen, si edhe pasojat e tyre juridike;
- e. mënyrat e administrimit të të dhënave të çdo doktoranti, në lidhje me veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore të tij;
- f. mënyrat e vlerësimit të progresit të bërë nga doktoranti dhe raportimit të tij;
- g. Kodi i etikës i dedikuar, që specifikon standardet etike të kërkimit, të cilat duhen respektuar, dhe rastet e procedurat kur, si pasojë e thyerjes së Kodit të Etikës doktoranti mund të përjashtohet nga studimet e doktoratës ose mund t' i anulohet grada shkencore.

Neni 29

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Senati Akademik ka të drejtën e Interpretimit të kësaj Rregulloreje.
Kjo rregullore u miratua me Vendimin nr. ____/datë ____/____/2024 të Senatit Akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.